



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odsajenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1973 Më 28.06.2018
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 12, shkronja (d), neneve 17, 34 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15,qershor 2008), neneve 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr.3323 të datës 28.08.2014, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.06.2018 merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në Komunën e Rahovecit

1. Emërohet Komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Rexhep Oruçi, anëtar/e i Kuvendit të Komunës, nga radhët e PDK-së
 - 1.2. Afrim Berisha, anëtar/e i Kuvendit të Komunës, nga radhët e AAK-së
 - 1.3. Faton Ramadani, anëtar/e i Kuvendit të Komunës, nga radhët e LDK-së
 - 1.4. Saranda Sallteku, anëtar/e nga ekzekutivi i Komunës,
 - 1.5. Përparim Krasnqi, anëtar/e nga ekzekutivi i Komunës,
 - 1.6. Adnan Rexha, anëtar/e nga shoqëria civile, SHL- Kosova
 - 1.7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjes urbane në qytet.
2. Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga vetë anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni i emëruar është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore për mbajtjen e tubimeve të qytetarëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane.
4. Komisioni i emëruar dhe përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve urbane bashkëpunojnë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale.
5. Komisioni ka për detyrë që përmes zyrës për informim, t'i informoj qytetarët për rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit me qytetarë, përmes mjeteve të informimit, ueb-faqës dhe shpalljeve publike në secilin fshat dhe lagjet e qytetit të Rahovecit, 15 ditë para mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave lokale në fshatra dhe qytet.
6. Komisioni ka për detyrë të mbaj procesverbal për çdo tubim, konform nenit 7 të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr.3323 të datës 28.08.2014.

7. Obligohet Komisioni që punët ti kryej duke u mbështetur në Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr.3323 të datës 28.08.2014
8. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së, dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. 1973
Rahovec, 28.06.2018

